



www.qbz.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 4

**Tiranë – E hënë, 29 janar 2024**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                             |                                                                                                                           | Faqe |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Urdhër i ministrit të Financave<br>nr. 1, datë 23.1.2024                                    | Për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit<br>dhe për ngritjen e komisionit <i>ad hoc</i> ..... | 3    |
| Kërkesë e Dhomës Kombëtare të<br>Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë<br>nr. 1172, datë 24.1.2024 | Për thirrje për shprehjen e interesit për hyrjen në provimin e<br>pranimit në trajnimin fillestar.....                    | 4    |





## URDHËR

Nr. 1, datë 23.1.2024

**PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE  
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË  
KONTABILITETIT DHE PËR  
NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 24, 25 dhe 26 të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; si dhe të nenit 3 dhe nenit 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK)”,

## URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të cilët janë subjekt i propozimeve të:

a) një anëtar propozohet nga shoqatat profesionale të kontabilitetit;

b) një anëtar propozohet nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njëjësive ekonomike të mëdha ose njëjësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave.

2. Kërkesat e posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i këshillit, të përcaktuara në nenin 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, janë si më poshtë:

a) Të ketë edukim në fushën e kontabilitetit dhe/ose financës;

b) Të jetë ekspert në teorinë dhe në metodologjinë e kontabilitetit (me titull /gradë) dhe, të paktën, 5 (pesë) vjetët e fundit të jetë i përfshirë drejtpërdrejtë në këtë fushë; ose praktikues i licencuar në fushën e kontabilitetit prej jo më pak se 10 (dhjetë) vjetësh; ose praktikues i palicencuar në fushën e kontabilitetit prej jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh;

c) Të ketë figurë të pastër morale dhe autoritet të njohur profesional.

3. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të KKK-së, sipas pikës 1 të këtij urdhri, kryhet nga një komision *ad hoc*, i cili përbëhet nga:

- Znj. Vasilika Vjero/zëvendësministër, MF: kryetar;

- Znj. Enkeleda Kuçi/drejtor i Politikave dhe Harmonizimit Fiskal të Legjislacionit për Tatimet Indirekte, MF: anëtar;

- Znj. Drinalda Ajazi/përgjegjës sektori DH/MFKK, MF: anëtar,

dhe kryen këto detyra:

- Njofton fillimin e procedurave (konkurrimit) të përzgjedhjes së kandidatëve të përcaktuar në pikën 1 të urdhrit;

- Shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe bën vlerësimin e kandidatëve bazuar në kërkesat e posaçme të parashikuara në nenin 3 të rregullores së organizimit dhe të funksionimit të KKK-së, miratuar me VKM-në nr. 505;

- Harton listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë urdhër, të shoqëruar me një relacion përmbledhës së bashku me rekomandimin për kandidatët e përzgjedhur;

- I rekomandon ministrit të Financave për miratim, listën e kandidatëve të përzgjedhur.

4. Njoftimi i konkurrimit për anëtar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, përmban të dhënat si më poshtë:

a) Një përshkrim të shkurtër të kompetencave e të funksionit që do të mbulojë anëtari;

b) Kërkesat për pranimin e kandidatëve;

c) Listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatën deri kur do të paraqiten dokumentet;

d) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen.

Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

5. Kandidatët, që do të aplikojnë sipas pikës 1 të këtij urdhri, duhet të dorëzojnë zyrtarisht pranë Ministrisë së Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me shkrim;

b) Kopje të pasaportës ose kartës së identitetit (ID);

c) *Curriculum vitae*;

d) Rekomandime që vërtetojnë figurën e pastër morale dhe autoritetin profesional të kandidatit;



e) Kopje të noterizuar të librezës së punës;  
f) Kopje të noterizuar të diplomës;  
g) Kopje të noterizuara të dëshmimeve e të certifikatave të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;

h) Dëshminë e penalitetit.

Dokumentet e përcaktuara në shkronjën “g”, të përfituara jashtë vendit, duhet të jenë të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e shpalljes së njoftimit.

7. Afati i shqyrtimit të dokumentacionit, vlerësimit, hartimit të listës së kandidatëve që plotësojnë kërkesat e posaçme dhe relacionit përkatës, si dhe paraqitja e listës për miratim nga ministri i Financave, i kryer nga komisioni *ad hoc*, është brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit.

8. Përzgjedhja e kandidatëve nga komisioni *ad hoc* do të bëhet në bazë të dokumentacionit të paraqitur pranë ministrisë së financave, duke vlerësuar si më poshtë:

a) Arsimi: 35 pikë;

b) Përvoja profesionale në fushën e kontabilitetit: 35 pikë;

c) Kualifikime në fushën e kontabilitetit dhe financës: 30 pikë.

9. Fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KKK-së që propozohet nga:

a) Organizata profesionale e audituesve ligjorë – 1 (një) anëtar;

b) Ministria e Financave, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave – 3 (tre) anëtarë;

10. Në rastin e anëtarit që përzgjidhet, sipas pikës 9 të këtij urdhri, institucionet përkatëse respektive duhet të paraqesin drejtpërdrejt kandidaturat pranë Ministrisë së Financave, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së këtij urdhri. Këto institucione janë përgjegjëse për plotësimin e kriterëve të posaçme, të parashikuara në pikën 2 të këtij urdhri, të kandidaturave të paraqitura për miratim nga ministri i Financave.

11. Ministri i Financave, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune, miraton anëtarët e KKK-së, nga lista e kandidatëve të propozuar, sipas pikës 1 dhe pikës 9 të këtij urdhri.

MINISTËR I FINANCEVE  
**Ervin Mete**

## KËRKESË

Nr. 1172, datë 24.1.2024

### PËR THIRRJE PËR SHPREHJEN E INTERESIT PËR HYRJEN NË PROVIMIN E PRANIMIT NË TRAJNIMIN FILLESTAR

Në përputhje me ligjin nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, dhe pas administrimit të urdhrit nr. 702, datë 18.12.2023, të ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e numrit të vendeve për kandidat përmbartues që do të pranohen në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbartuesve për vitin 2023”, Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë publikon thirrjen për shprehje interesi për hyrjen në provimin e pranimit në trajnimin fillestar.

Numri i vendeve për kandidat përmbartues, që do të pranohen në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbartuesve për vitin 2023, është 20 kandidatë.

Kanë të drejtë të marrin pjesë në provimin e pranimit në trajnimin fillestar kandidatët që plotësojnë **kushtet**, si më poshtë, referuar nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”:

1. Të jetë shtetas shqiptar;

2. Të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

3. Të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit ose diplomë të njësuar me të, apo të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

4. Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

i. për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën nuk është rehabilituar;

ii. për një vepër penale të kryer me pakujdesi, për të cilën nuk është rehabilituar dhe që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbartuesit gjyqësor privat;

iii. për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën është rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbartuesit gjyqësor privat;



5. Të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë.

Kandidati që kalon me sukses provimin e pranimi në programin e trajnimit fillestar, pranohet për të ndjekur programin e detyrueshëm 1-vjeçar për trajnimin fillestar, pranë Qendrës së Trajnimit, përkundrejt pagimit të tarifës së pranimi 300 000 lekë.

Shprehja e interesit duhet të depozitohet brenda datës **23.2.2024**, në **rrugë postare**, në **adresën** e selisë së Dhomës Kombëtare: *rruga "Nikolla Jorga", ndërtesa 9, kati II, Tiranë*, shoqëruar me **dokumentacionin si vijon**:

1. Kërkesë për shprehje interesi, me arsyet përkatëse që mbështesin pjesëmarrjen në këtë provim;

2. Jetëshkrim;

3. Kopje e kartës së identitetit;

4. Kopje e njësuar e diplomës, që vërteton përfundimin e programit të ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose të diplomës së njësuar me të apo të diplomës që vërteton përfundimin e studimeve universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

5. Certifikatë e gjendjes gjyqësore, e muajit në të cilin bëhet aplikimi;

6. Kopje e njësuar e librezës së punës dhe e vërtetimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që vërtetojnë vjetërsinë në punë;

7. Vërtetim nga punëdhënësit që nuk janë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë.

8. Mandatpagesën për aplikimin dhe dorëzimin e dokumentacionit: 10 000 lekë si tarifë aplikimi, që do të paguhet në llogarinë bankare:

**Emri i institucionit: Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbauesve**

**Emri i bankës: Intesa Sanpaolo Bank**

**Nr. i llogarisë: 1060 5318 02**

**IBAN: AL 8020 8110 0800 0000 1060 5318 02**

**Përshkrimi: Pagesë për aplikim dhe dorëzim dokumentacioni të (Emër Mbiemër).**

Kandidatët që përmbushin kushtet për t'u pranuar në provim do të njoftohen përmes publikimit të listës emërore në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, brenda 10 ditëve nga mbyllja e afatit të aplikimit.

Provimi i pranimi në formimin fillestar do të zhvillohet në datën **3.5.2024**, ora **10:00**, pranë selisë së Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë ose në një ambient tjetër të caktuar dhe njoftuar prej saj, në varësi të numrit të kandidatëve aplikantë, që do të marrin pjesë në provim. Lista emërore të kandidatëve do të afishohen ditën e provimit pranë ambienteve të zhvillimit të provimit.

Rregullat e detajuara për zhvillimin e provimit të pranimi, për kontrollin e njohurive dhe fusha e testimit janë sipas përcaktimeve të urdhrit nr. 364, datë 31.5.2021, të ministrit të Drejtësisë, "*Për miratimin e Programit të detyrueshëm për trajnimin fillestar*", publikuar edhe në Fletoren Zyrtare.

Kjo thirrje shpallet në Buletin e Njoftimeve Zyrtare, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, sipas përcaktimeve ligjore.





Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2024